

## HYRJJE

Misioni i UNIKO i përcaktuar edhe në statutin e tij e vë theksin në krijimin, transmetimin, zhvillimin dhe mbrojtjen e dijeve me anë të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve. Ky mision realizohet ndër të tjera edhe nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të politikave, parimeve dhe procedurave të cilat mbikëqyrin procesin e mbështetjes financiare dhe logjistike që UNIKO ofron për njësitë e saj akademike dhe ndihmësakademike. Për këtë arsye, synimi kryesor i strukturave mbështetëse për kërkimin shkencor në UNIKO është përqendruar në ndërtimin e mekanizmave kërkimore institucionale të lidhur me programe të përcaktuara mirë, prioritete të qarta dhe me ofrimin e shpërblimeve dhe vlerësimeve si nxitës për përfshirjen e stafit akademik në veprimtari kërkimore-zhvillimore cilësore, pa lënë mënjanë elemente të produktit shkencor, publikimet, partneritetet, marketingun kërkimor dhe ofrimin e shërbimeve për të tretë, për ta ngritur Kërkimin shkencor në UNIKO të përafrueshëm me standardet e përcaktuara në Zonën Evropiane të Kërkimit Shkencor..

Duke pasur parasysh këtë qëllim, synimi i strukturave përgjegjëse për KSH në nivel institucioni dhe njësie akademike shprehet në angazhimin për rritjen dhe fuqizimin e:

- Burimeve njerëzore
- Infrastrukturës kërkimore
- Bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar
- Lidhjes me ekonominë dhe shoqërinë

Theksi është vendosur gjithashtu edhe në nxitjen e hapjes shkencore përmes organizimit të veprimtarive periodike, konferencave shkencore, posterave promocialë, duke rritur kërkimin ndërdisiplinor dhe bashkëpunues, si dhe duke ju përafruar standardeve të cilësisë në rritjen e kulturës kërkimore për të shkuar drejt krijimit të qendrave kërkimore. Po kështu, një masë tjetër për realizimin e objektivave systrategjike është edhe ngritja e Qendrës së Inovacionit duke hedhur bazat për inovacionin shkencor, gjurmimin e ideve të reja, teknologjive bashkëkohore, spin-off me shtrirje të madhe dhe prirje për t'u lidhur me industrinë dhe marketingun kërkimor.